



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 133/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.03.2019 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-99519-12-17-2018, me objekt, “*Ndërtim rrjet kanalizimi në zonën që kufizohet nga rrugët "Besnik Hidri", "Bashkim Shkurti", "Coca Cola" deri në lumin "Lana"*”, me fond limit 75.745.805 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 18.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

Ankimues: “Curri” sh.p.k.
Rruga “Kajo Karafili”, Nd.2, H.4, Ap.3, Njësia Bashkiake Nr.10, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.
Rruga “5 Maj”, pranë Medresesë, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.12.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-99519-12-17-2018, me objekt, “Ndërtim rrjet kanalizimi në zonën që kufizohet nga rrugët “Besnik Hidri”, “Bashkim Shkurti”, “Coca Cola” deri në lumin “Lana”, me fond limit 75.745.805 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 18.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2. Në datën 18.01.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në

datë 31.01.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--|----------------------------------|
| 1. “Bajrami N” sh.p.k. | 58.225.721,4 lekë, skualifikuar |
| 2. BOE “Pepa Group” sh.p.k. & “Junik” sh.p.k. | 62.545.701,75 lekë, skualifikuar |
| 3. “Curri” sh.p.k. | 66.444.504 lekë, skualifikuar |
| 4. BOE “Arb & Trans-2010” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. | 70.278.075 lekë, kualifikuar |
| 5. “Eurondërtimi 2000” sh.p.k. | 71.008.140 lekë, skualifikuar |
| 6. “Sireta 2F” sh.p.k. | 72.892.244 lekë, skualifikuar |
| 7. “Shpresa-Al” sh.p.k. | 74.274.560,1 lekë, skualifikuar |
| 8. “Liqeni VII” sh.p.k. | 74.940.915 lekë, skualifikuar |

II.4. Në datën 31.01.2019, operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, I ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

13.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

Mjetet Sasia Gjendja

Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5 (pese) ton dhe maksimumi 10 (dhjete) ton për secilin kamion 3 copë

Pronësi ose me qera

Fadrome me goma 2 copë Pronësi ose me qera

Eskavator me goma 0.25 m3 2 copë Pronësi ose me qera

Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15 (pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20 (njëzetë) ton për secilin kamion 3 copë Pronësi ose me qera

Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë 4 cope

Pronësi ose me qera

Pompe uji 1 cope Pronësi ose me qera

Vinç 1 cope Pronësi ose me qera

Tokmak 1 cope Pronësi ose me qera

Motogjenerator 1 cope Pronësi ose me qera

Asfaltshtruese 1 cope Pronësi ose me qera

Prerese asfalti 1 cope Pronësi ose me qera

Rrul 2 cope Pronësi ose me qera

Sonde shpimi 1 cope Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 90 copë

- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerash/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

3. Operatori ekonomik "CURRI" shpk në përmbushje të kriterit të mësipërm kanë deklaruar në shtojcën nr.10 se disponojnë mjetet e mëposhtme:

1) Rimorkio me targa SH4581E me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 29 Ton

2) Kamion me targa AA145RA me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 10.7 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)

3) Kamion me targa SH1986E me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 12.3 Ton

4) Kamion me targa SH3625D me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 9.1 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)

5) Kamion me targa SH6587E me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 10.6 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)

6) Kamionçinë me targa AA653HA me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.2 Ton

7) Kamionçinë me targa AA395OS me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 0.9 Ton

- 8) Kamionçinë me targa AA179OL me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.3 Ton
- 9) Kamionçinë me targa AA244UC me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.03 Ton
- 10) Kamion me targa AA485GM me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 16.4 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)
- 11) Kamion me targa AA948UG me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3 Ton
- 12) Kamion me targa AA182OL me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8.2 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)
- 13) Kamion me targa AA209RF me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 24.4 Ton
- 14) Kamion me targa KR7093A me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 27.9 Ton
- 15) Kamion me targa AA562AD me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25 Ton
- 16) Kamion me targa AA045OV me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25.8 Ton
- 17) Kamion me targa KR8096A me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 23.7 Ton
- 18) Kamion me targa AA276EN me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25.4 Ton
- 19) Kamion me targa KR6381A me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 24.2 Ton
- 20) Kamion me targa KR6998A me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 27.2 Ton

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamionçina vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secilin kamionçinë për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nuk ka paraqitur asnjë kamionçinë me tonazhin e kërkuar nga AK. Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionçinë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 1.5 ton dhe maksimumi 2 ton për secilin kamionçinë të kërkuar nga AK (4 cope), për rrjedhojë i pavlefshëm. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 15 ton dhe maximum 20 ton secilin kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur një kamion me tonazhin e kërkuar nga AK. Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 15 ton dhe maksimumi 20 ton për secilin kamionçinë të kërkuar nga AK (3 cope), për rrjedhojë i pavlefshëm.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik i mësipërm është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur mjetet në mënyrën e kërkuar në dokumentat standarte të tenderit të kërkuar nga AK;

Pra sa më sipër operatori ekonomik “CURRI” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Gjithashtu sqarojme se nuk jemi në kushtet e nenit 53, pika 1 e LPP në të cilin përcaktohet se “Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”, pasi sqarimet mund të kërkohej vetëm në rast se autoriteti kontraktor e shikon të nevojshme dhe arsyeshme për vërtetësinë e dokumentacionit dhe jo në rastin konkret. Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55/2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” në të cilën citohet se ...Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Pra, përfundimisht K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përmbushjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.”

II.5. Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. në datën 05.02.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike. Konkretisht operatori ekonomik ankimes në ankesën e tij argumenton si më poshtë vijon:

[...]Në përmbushje të kërkesave Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10), Autoriteti Kontraktor ka kërkuar të kemi në dispozicion:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera

Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	4 cope	Pronësi ose me qera
--	--------	---------------------

Operatori ekonomik "Curri" sh.p.k. ka paraqitur ne kete procedurë prokurimi automjetet si më poshtë:

Kamioncina:

- Kamioncine me targa AA653HA me kapacitet mbajtesi 1.2 ton
- Kamioncine me targa AA395OS me kapacitet mbajtesi 0.9 Ton
- Kamioncine me targa AA179OL me kapacitet mbajtesi 1.3 Ton
- Kamioncine me targa AA244UC me kapacitet mbajtesi 1.03 Ton

Ne kemi përmbushur kërkesën e autoritetit kontraktor për të disponuar 4 automjete kamioncina. Ndarja qe ju i keni bere tonazhit nga 1.5-2 ton, eshte ne kundërshtim me ligjin Nr 8378, date 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikes se Shqiperise", i ndyshuar dhe aktet e tjera ligjore. Per te permbushur kriterin e kerkuar - Kamion veteshkarkues kapaciteti mbajtes duhet te jete minimum 15 ton dhe maximum 20 ton secilin, kemi paraqitur:

1. Rimorkio me targa SH4581E me kapacitet mbajtes 29 Ton
2. Kamion me targa SH1986E me kapacitet mbajtes 12.3 Ton
3. Kamion me targa AA485GM me kapacitet mbajtes 16.4 Ton
4. Kamion me targa AA948UG me kapacitet mbajtes 3 Ton
5. Kamion me targa AA182OL me kapacitet mbajtes 8.2 Ton
6. Kamion me targa AA209RF me kapacitet mbajtes 24.4 Ton
7. Kamion me targa KR7093A me kapacitet mbajtes 27.9 Ton
8. Kamion me targa AA562AD me kapacitet mbajtes 25 Ton
9. Kamion me targa AA045OV me kapacitet mbajtes 25.8 Ton
10. Kamion me targa KR8096A me kapacitet mbajtes 23.7 Ton
11. Kamion me targa AA276EN me kapacitet mbajtes 25.4 Ton
12. Kamion me targa KR6381A me kapacitet mbajtes 24.2 Ton
13. Kamion me targa KR6998A me kapacitet mbajtes 27.2 Ton

Nuk kuptojmë arsyen se pse KVO e autoritetit kontraktor ka skualifikuar ofertën tonë. Të gjithë automjetet që ne kemi paraqitur bëjnë të mundur zbatimin korrekt të kontratës dhe nuk ndikon tonazhi i mjeteve në zbatimin me cilësi të kontratës. Nuk di se ku eshte bazuar autoriteti kontraktor qe ka bere kete klasifikim te automjeteve te transportit?!

- Kamioncine veteshkarkues kapaciteti mbajtes duhet te jete minimum 1.5 ton dhe max 2 ton secilin
- Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5 (pesë) ton dhe maksimumi 10 (dhjete) ton per secilin kamion.
- Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 15 ton dhe maximum 20 ton secilin.

Referuar ligjit Nr 8378, date 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikes se Shqiperise" i ndyshuar dhe aktet e tjera ligjore, Ligjit Nr 8308, date 18.03 1998 "Per transportet rrugore" I ndryshuar dhe te gjithë akteve te tjera nenligjore VKM, Udhezime, etj, ndarja e automjeteve të transportit të mallrave eshte:

- ATP-Automjete te transportit te Posacem (Kamioncine) me mase maksimale te autorizuar deri ne 3.5. ton
- Kamion me mase maksimale te autorizuar nga 3.5 deri ne 7.5 ton

- Kamion me mase maksimale te autorizuar nga 7.5 deri ne 18 ton
- Kamion me mase maksimale te autorizuar mbi 18 ton

Kerkojme KVO se autoritetit kontraktor te na jape shpjegime dhe bazen ligjore, se ku e ka mbeshtetur kete ndarje apo klasifikim te mjeteve.

Ne kete kushte, oferten tone e konsiderojme te vlefshme, te rregullt dhe ne plotesim te kerkesave te DST dhe legjislacionit ne fuqi per transportet. Gjithesesi, ne paralelisht i jemi drejtuar me nje kerkese per sqarim Drejtorise se Pergjithshme te Transportit Rrugor ne lidhje me kriteret qe ju keni vendosur per klasifikimin e automjeteve te transportit dhe vleresimin qe ka bere KVO e Autoritetit Kontraktor UKT Sh a. I nderuar Zoti Titullar i Autoritetit Kontraktor ky vleresim i bere nga KVO, nuk eshte aspak profesional dhe ligjor. Ne kerkojme kuotimin e ofertes tone ne kete procedure prokurimi. Duke qene se kemi shume eksperience me prokurimet publike dhe duke respektuar ligjin, dhe duke besuar ne vleresimin dhe gjykimin Tuaj te drejte, ne do te presim vendimin tuaj ne lidhje ankesen tone per vleresimin e bere nga Anetaret e KVO se Autoritetit kontraktor, nisur edhe nga faktet e vene ne dispozicion, presim vendimin Tuaj. Nderkohe, qe qendrimi ne lidhje me anetaret e Komisionit te Vleresimit te Ofertave, do te jete ne perputhje me ligjin, ne do te ndjekim te gjitha rruget ligjore administrative dhe penale qe persona te tille dhe vleresime te tilla te mos ndodhin me. Ne do presim vendimin Tuaj dhe me pas do te ndjekim te gjitha rruget ligjore administrative dhe penale per te siguruar nje proces te drejte dhe transparent te pjesmarrjes ne kete procedure prokurimi dhe kriterëve te vendosur per pjesmarrjen. Por, meqenese ju po kerkoni te gjeni arsye pa arsye vetem me qëllim te skualifikoni oferten tone dhe te favorizoni kompanine tuaj te preferuar, po ju bejme me dije se, do tju drejtohem organeve te prokurorise per te ndaluar kete tentative te anetareve te KVO dhe Autoritetit Kontraktor per te favorizuar nje operator ekonomik ne kete procedure prokurimi dhe per te skualifikuar oferten tone ndonese oferta jone eshte me vlere me te ulet se e operatorit tjeter qe kerkoni te favorizoni me keto manovra e ndarje absurde te tonazhit ne sistemin e transportit te mallrave. Me kete kuotim jeni duke i shkaktuar nje dem ekonomik rreth 4 milion leke te reja. Nuk do te rrimë pa e denoncuar kete fakt.

II.6. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 07.02.2019, me anë të shkresës nr.2515/1 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor argumenton:

“[...]Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. në formularin e ankesës sipërcituar pretendon anullimin e vendimit të KVO-së të AK, UKT sh.a si dhe kualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi shqyrtoi pretendimet e ankimuesit si dhe materialin e vënë në dispozicion në dosjen e procedurës së prokurimit si dhe sistemin elektronik të prokurimeve, sqaron se: 1. Për sa i përket arsyes së parë të skualifikimit në të cilën përcaktohet se:

“13.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjete) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera

<i>Fadrome me goma</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me goma 0.25 m3</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë</i>	<i>4 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pompe uji</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vinç</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Tokmak</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Motogjenerator</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Prerese asfalti</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Sonde shpimi</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 90 copë*
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë*
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë*
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë*

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerash/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë*

nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi). ”

Operatori ekonomik "Curri" shpk ne permbushje te kriterit te mesiperm kane deklaruar ne shtojcen nr.10 se disponojne mjetet e meposhtme:

- 1) Rimorkio me targa SH4581E me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 29 Ton*
- 2) Kamion me targa AA145RA me kapacitet mbajtesi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 10.7 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet ne kategorine me kapacitet mbajtes 5-10 ton)*
- 3) Kamion me targa SH1986E me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 12.3 Ton*
- 4) Kamion me targa SH3625D me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 9.1 Ton (do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)*
- 5) Kamion me targa SH6587E me kapacitet mbajtesi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 10.6 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet ne kategorine me kapacitet mbajtes 5-10ton)*
- 6) Kamioncinë me targa AA653HA me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per këtë mjet 1.2 Ton*
- 7) Kamioncine me targa AA3950S me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 0.9 Ton*
- 8) Kamioncine me targa AA179OL me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 1.3 Ton*
- 9) Kamioncine me targa AA244UC me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 1.03*
- 10) Kamion me targa AA485GM me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 16.4 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet ne kategorine me kapacitet mbajtes 5-20 ton)*
- 11) Kamion me targa AA948UG me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 3 Ton*
- 12) Kamion me targa AA182OL me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 8.2 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet ne kategorine me kapacitet mbajtes 5-10 ton)*
- 13) Kamion me targa AA209RF me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 24.4 Ton*
- 14) Kamion me targa KR7093A me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 27.9 Ton*
- 15) Kamion me targa AA562AD me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 25 Ton*
- 16) Kamion me targa AA045OV me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 25.8 Ton*
- 17) Kamion me targa KR8096A me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 23.7 Ton*

- 18) Kamion me targa AA276EN me kapacitet mbajtesi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 25.4 Ton
- 19) Kamion me targa KR6381A me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 24.2 Ton
- 20) Kamion me targa KR6998A me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur per kete mjet 27.2 Ton

Autoriteti Kontraktor ka kerkuar, ti vihet ne dispozicion kater kamioncine veteshkarkues kapaciteti mbajtes duhet te jete minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secilin kamioncine per ekzekutimin e kontrates. Operatori Ekonomik ne permbushje te ketij kriteri nuk ka paraqitur asnje kamioncine me tonazhin e kerkuar nga AK. Pra sa me siper cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcen 10, eshte i paplote lidhur me kamioncine veteshkarkues me kapacitet mbajtes minimum 1.5 ton dhe maksimumi 2 ton per secilin kamioncine te kerkuar nga AK (4 cope), per rrjedhoje i pavlefshem. Autoriteti Kontraktor ka kerkuar ti vihet ne dispozicion tre kamion veteshkarkues kapaciteti mbajtes duhet te jete minimum 15 ton dhe maximum 20 ton secilin kamion per ekzekutimin e kontrates. Operatori Ekonomik ne permbushje te ketij kriteri ka paraqitur nje kamion me tonazhin e kerkuar nga AK. Pra sa me siper cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcen 10, eshte i paplote lidhur me kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes minimum 15 ton dhe maksimumi 20 ton per secilin kamioncine te kerkuar nga AK (3 cope) per rrjedhoje i pavlefshem.

Per sa me siper Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik I mesiperm eshte paplote pasi nuk ka permbushur kriteret e Vecanta te Kualifikimit/Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur mjetet ne menyren e kerkuar ne dokumentat standarte te tenderit te kerkuar nga AK;

Pra sa me siper operatori ekonomik "CURRI" shpk nuk zoteron kapacitet te mjaftueshem teknik per sa I perket mjeteve per te realizuar kontraten per kete objekt prokurimi duke mos permbushur Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, cka bie ne kundërshtim me piken 1 germa (a) dhe (b) te nenit 46 te ligjit nr 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin Publik" i ndryshuar ku percaktohe se: "Operatoret ekonomik, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen pasi te kene permbushur te githa kriteret e meposhtme qe AK i vlereson te nevojshme". Gjithashtu sqarojme se nuk jemi ne kushtet e nenit 53, pika 1 e LPP ne te cilin percaktohet se "Autoriteti kontraktor, kur e shikon te arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime per ofertat e tyre, per shqyrtimin vleresimin dhe krahasimin sa me te drejte te ketyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara ne nenet 32 dhe 33 te keti ligji, kuk duhet te kerkohet, ofrohet apo lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes perfshire ndryshimet ne cmim apo ndryshime qe synojne te kthejne nje oferte te pavlefshme ne te vlefshme", pasi sqarimet mund te kerkohen vetem ne rast se autoriteti kontraktor e shikon te nevojshme dhe arsyeshme per vertetesine e dokumentacionit dhe jo ne rastin konkret. Ne kete rast KVO eshte e detyruar te zbatoje nenin 55/2 te ligjit nr 9643, date 2011.2006 "Per prokurimin Publik" ne te cilen citohet se .. Autoriteti Kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme per te percaktuar oferten fituese ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne dokumentat e tenderit. Pra, perfundimisht KVO gjykon se duhet te vleresoje permbushjen e cdo kriteri per kualifikim qe gjendet ne DT dhe operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatitin ofertat dhe te paraqesin te plote dokumentacionin e kerkuar ne DT. Komisioni i Vleresimit te Ofertave nga shqyrtimi i kesaj oferte ne mbështetje te Nenit 53 pika 5, te Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006, "Per Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr 914. date 29.12.2014 "Per miratimin e

rregullave te prokurimit publik, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall te pavlefshme kete oferte pasi nuk ploteson kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit. KSHA, pasi ka marre ne shqyrtim ankesen e operatori ekonomik dhe pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nga kjo shoqeri mbi plotesimin e ketij kriteri, ka konstatuar se: Operatori ekonomik ankimues nuk e permbush kriterin e percaktuar nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit per paraqitjen e 6 mjeteve nga te cilat kater kamioncina me tonazh 1.5 - 2 ton dhe dy kamion me tonazh 15-20 ton. Së pari persa i perket arsytimit tuaj ne lidhje me faktin se skualifikimi lidhur me mjetet te cilat nuk plotesojne tonazhin te percaktuar ne Dokumentat Standarte te Tenderit se Autoriteti Kontraktor eshte treguar i padrejte. Sqarojme se kapaciteti-mbajtes ne mbeshtetje te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne lejen e qarkullimit referuar nr. 23 përfaqëson peshën kufitare të përgjithshme me ngarkesë të plotë të mjetit qe perbehet nga pesha e vete mjetit te gatshem per levizje dhe nga ajo e ngarkeses se tij dhe referuar Nr 24 të lejes se qarkullimit te mjetit duhet te paraqitet pesha e vete mjetit te gatshem per levizje. Pra sa me siper cituar kapaciteti mbajtes apo ngarkesa e mjetit eshte "Pesha kufitare e pergjithshme me ngarkese te plote e mjetit - peshen e vete mjetit te gatshem per lëvizje". Bejme me dije gjithashtu qe ne mbeshtetje te Ligjit 9643, date 20. 11.2006 "Per prokurimin publik" si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", Neni 78 "Ankesat ne autoritetin kontraktor", ligjvenesit ka parashikuar ankimimin per dokumentat e tenderit, pra operatori ekonomik ka patur mundesi te ankimohet per dokumentat e tenderit para hapjes se procedures se prokurimit. Pjesemarrja e tij ne kete procedure dhe paraqitje e ofertes nga ana e shoqerise presupozon qe ka marre persiper te permbushe te gjitha kriteret qe Autoriteti Kontraktor I vlereson te nevojshme per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese. Keto kriteret te vendosura nga ana e autoritet kontraktor nuk jane kontestuar nga ana e operatorit ekonomik pra jane konsideruar nga ana e ketij operatori si kriteret ne perputhje te plote me ligjin dhe aktet nenligjore ne fuqi. Sa me siper pretendimi i pales ankimuese ne lidhje me plotesimin e kriterëve te vecanta per kualifikim nuk qendron pasi theksojme edhe njehere kamionat e paraqitur ne shtojcen nuk plotesojne kriterin e kerkuar nga ana e AK-se dhe komisioni I shqyrtimit te ankesave vendos te lere ne fuqi vendimin e Komisionit te Vleresimit te Ofertave per proceduren e prokurimit me objekt "Nderitim rrjet kanalizimi i rrugeve Besnik Hidri, Bashkim Shkurti, Coca Cola deri ne Lane". Gjykojme se eshte barre e operatorit ekonomik ankimues pjesemarrjes ne procedure e prokurimit objekti shqyrtimi, te vertetoje se disponon kapacitetet teknik ne lidhje me mjetet. Sqarojme se, kriteri per mjetet duhet pare dhe vleresuar ne teresine e tij, me te gjithe elementet e kerkuar dhe percaktuar nga autoriteti në dokumentat e tenderit, pasi referuar mangësive dhe pasaktësirave të konstatuara në dokumentacion nuk arrihet te plotesohet tonazhi i kerkuar i mjeteve, pare kjo ne kendveshtrimin e vleresimit te te gjitha te dhenave te kerkuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit. Ne rastin konkret, per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron kapacitetet teknike (makinerite), ne perputhje me volumen e percaktuar ne dokumentat e tenderit. KSHA gjykon se ne rast se operatori ekonomik ankimues do te kishte pretendime ne lidhje me kerkesen e mesiperme te autoritetit kontraktor, ka patur ne dispozicion momentin procedural te paraqitjes se ankeses mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve te vecanta te kualifikimit te procedures se prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP [...].

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon nje sere elementesh si garanci per operatorët ekonomike te cilet kane paqartesi ne lidhje me interpretimin e kerkesave te autoritetit kontraktor dhe/ose menyres

se plotesimit te kriterëve kualifikuese. Ne rast se operatori ekonomik ankimues do te kishte paqartesi ne lidhje mbi plotesimin e kerkeses se mesiperme, ka ne dispozicion momentin procedural te paraqitjes se kerkeses per sqarime prane autoriteit kontraktor deri ne pese dite para dorezimit te ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-se. Ne nenin 42, pika 1 te ligjit nr.9643 date 20.11 2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se [...].

Per sa me siper pretendimi i pales ankimuese nuk qendron pasi theksojme edhe njehere makinerite e paraqitura nga shoqeria nuk plotesojne kriterin e kerkuar nga ana e AK-se dhe komisioni I shqyrtimit te ankesave vendos te lere ne fuqi vendimin e Komisionit te Vleresimit te Ofertave per proceduren e prokurimit me objekt "Ndertim rrjet kanalizimi i rrugeve Besnik Hidri, Bashkim Shkurti, Coca Cola deri ne Lane".

II.7. Në datën 13.02.2019 operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjta pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Në lidhje me kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor, operatori ekonomik ankimues ka argumentuar si më poshtë vijon:

[...] Ne pergjigjen e tij Autoriteti Kontraktor sqaron (paragrafi 1, faqe 7):

Se pari, per sa i perket arsyetimit tuaj ne lidhje me faktin se skualifikimi lidhur me mjetet te cilat nuk plotesojne tonazhin te percaktuar ne Dokumentet Standarte te Tenderit se Autoriteti Kontraktor eshte treguar i padrejte, Sqarojme se kapaciteti mbajtes ne mbeshtetje te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne lejen e qarkullimit referuar Nr.23 perfaqeson peshen kufitare te pergjithshme me ngarkese te plote te mjetit qe perbehet nga pesha e vete mjetit te gatshem per levizje dhe ajo e ngarkeses se tij dhe referuar Nr.24 te lejes se qarkullimit te mjetit duhe paraqitet pesha e vete mjetit te gatshem per levizje. Per sa me siper cituar kapaciteti mbajtes apo ngarkesa e mjetit eshte: "Pesha kufitare e pergjithshme me ngarkese te plote te mjetit - peshen e vete mjetit te gatshem per levizje".

Sqarim1

Ndonese, e lexuam disa here kete paragraf sqarues qe ka shkruar autoriteti kontraktor ne pergjigjen e tij, serisht nuk mundem te kuptojme asgje nga ky sqarim. As me shume, e as me pak, kjo pergjigje eshte nje shpikje e re ne fushen e Fizikes. Qellimisht, Autoriteti Kontraktor, ka ngaterruar dy koncepte shume te rendesishme dhe elementare te Fizike "Masa" dhe "Pesha". Pesha (P) eshte forca me te cilen cdo trup terhiqet drejt qendre se Tokes. Ajo eshte e ndryshueshme sepse varet nga pozicioni i trupit ne lidhje me token. $P=m \times g$, ku g – eshte nxitimi i renies se lire ne toke 9.8 m/s^2 . Niesia matese e peshes eshte Njutoni dhe shenohet me (N). Masa eshte nje veti e brendshme e trupit ajo nuk varet nga kushtet ku ndodhet trupi. Ajo na jepnje ide se sa lende ka ne nje trup. Ne sistemin SI, njesia matese e mases eshte kilogrami dhe shenohet me (kg). Pervec, kesaj ngaterrese te qellimshme te koncepteve, Autoriteti Kontraktor ne shpjegimet e veta perdor terma dhe terminologji qe nuk jane te mbeshtetura ne asnje ligj apo akt nenligjor ne fuqi, si keto me poshte:

- ne lejen e qarkullimit referuar Nr.23 perfaqeson peshen kufitare te pergjithshme me ngarkese te plote te mjetit qe perbehet nga pesha e vete mjetit te gatshem per levizje dhe ajo e ngarkeses se tij dhe referuar Nr.24 te lejes se qarkullimit te mjetit duhet paraqitet pesha e vete mjetit te gatshem per levizje.
- “Pesha kufitare e pergjithshme me ngarkese te plote te mjetit - peshen e vete mjetit te gatshem per levizje”

Referuar, ligjit Nr.8378, date 22.07 1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndyshuar dhe aktet e tjera ligjore, Ligjit Nr.8308, date 18.03.1998 "Per transporter rrugore" I ndyshuar dhe te gjithë akteve te tjera nenligjore VKM, Udhezime, etj, por edhe referuar Lejes se Qarkullimit, ne permbajtjen e saj kemi:

Nr. 23, masa maksimale e autorizuar (kg)

Nr. 24, masa e mjetit bosh (kg)

Masa maksimale e autorizuar, eshte masa e mjetit bosh + ngarkesen qe do te transportohet.

Sqarim 2

Per anetaret e KPP po japim edhe nje sqarim tjeter te nevojshem. Gjithesesi, nese do te duhet te thirret ekspert ne kete fushe, ju jeni te lire ta therrisni, por ne do tju bejme thjeshte sqarim per te kuptuar se sa e kamufluar dhe e pa mbeshtetur ne ligj eshte klasifikimi automjeteve i bere nga Autoriteti Kontraktor dhe arsyetimi qe ka bere vete autoriteti kontraktor. Referuar, ligjit Nr.8378, date 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" I ndyshuar dhe aktet e tjera ligjore, Ligjit Nr.8308, date 18.03.1998 "Per transporter rrugore" I ndyshuar dhe te gjithë akteve te tjera nenligjore VKM, Udhezime, etj, ndarja e automjeteve te transportit te mallrave eshte

- ATP - Automjete te Transportit te Posacem (Kamioncine) me mase maksimale te autorizuar deri ne 3.5 ton
- Kamion me mase maksimale te autorizuar nga 3.5 deri ne 7.5 ton
- Kamion me mase maksimale te autorizuar nga 7.5 deri ne 18 ton
- Kamion me mase maksimale te autorizuar mbi 18 ton

Le te marrim rastin e Kamioncinave ose te quajtur ndyshe Automjete te Transportit te Posacem (ATP), sic percaktohet ne lejen e qarkullimit ne permbajtjen e saj me nr.1 - Lloji.

Disponojme 4 kamioncina te tilla ATP. Te gjitha e kane masen maksimale te autorizuar 3.5 ton. Te gjitha kamioncinat, e kane masen e mjetit bosh perkatesisht:

Targa AA179OI, 2200 kg (2.2 ton)

Targa AA244UC, 2450 kg (2.45 ton)

Targa AA395OS, 2590 kg (2.59 ton)

Targa AA653HA, 2300 kg (2.3 ton)

Le te marrim, automjetin me masen e vet me te vogel 2.2 ton. Le ti shtojme mases se mjetit dhe kapacitetin minimal qe sipas DST ka percaktuar autoriteti kontraktor (nga 1.5 ne 2 ton) po marrim 1.5 ton. Masa maksimale e autorizuar = 2.2 ton + 1.5 ton = 3.7 ton. Qe e tejkalon masen maksimale te autorizuar per Automjetet e Transportit te Posacem (ATP), qe eshte 3500 kg (ose 3.5 ton). Po te marrim, masen maksimale te kerkuar ne DST, 2 ton, masa maksimale e autorizuar shkon ne 4.2 ton. Pra, totalisht ne kundershtim me ligjin ne kete sektor, jane bere keto kategorizime. Nje mendje e djallezuar, mund te thote qe masa e mjetit bosh duhet te jete me vogel qe te plotesohet kushti per te transportuar nje ngarkese te dobishme 1.5 ton. Por, serisht ligjet e fizikes dhe te mekanikes na ndihmojne per te kuptuar se nuk mundet te transportohet nje mase e dobishme 1.5 apo 2 ton, nga nje mjet me mase te veten me te vogel.

Sqarim 3

I njejt arsyetim, vlen edhe ne rastin e kerkesave dhe kategorizimit te kamioneve. Per te permbushur kriterin e kerkuar - Kamion veteshkarkues kapaciteti mbajtes duhet te jete minimum 15 ton dhe maximum 20 ton secilin. Por, ne kete rast, kemi drejtuar edhe nje pyetje tjeter qe vlen te behet per autoritetin kontraktor. Ne kemi paraqitur ne kete procedure prokurimi nje flote te tere kamionesh ne pronësi dhe me qira, si me poshtë:

1. Rimorkio me targa SH4581E me kapacitet mbajtes 29 Ton
2. Kamion me targa SH1986E me kapacitet mbajtes 12.3 Ton
3. Kamion me targa AA485GM me kapacitet mbajtes 16.4 Ton
4. Kamion me targa AA948UG me kapacitet mbajtes 3 Ton
5. Kamion me targa AA182OL me kapacitet mbajtes 8.2 Ton
6. Kamion me targa AA209RF me kapacitet mbajtes 24.4 Ton
7. Kamion me targa KR7093A me kapacitet mbajtes 27.9 Ton
8. Kamion me targa AA562AD me kapacitet mbajtes 25 Ton
9. Kamion me targa AA045OV me kapacitet mbajtes 25.8 Ton
10. Kamion me targa KR8096A me kapacitet mbajtes 23.7 Ton
11. Kamion me targa AA276EN me kapacitet mbajtes 25.4 Ton
12. Kamion me targa KR6381A me kapacitet mbajtes 24.2 Ton
13. Kamion me targa KR6998A me kapacitet mbajtes 27.2 Ton

Cila eshte aresyeja qe autoriteti kontraktor na ka skualifikuar. Me mjetet qe disponojme, a behet e mundur transporti i mallrave min 15 ton dhe maksimumi 20 ton, kur ne kemi mjete me kapacitete mbajtese te mases qe varion nga 16 ton dhe deri ne 27.9 ton?! Kjo pyetje ende nuk ka marre pergjigje nga Autoriteti Kontraktor. Ne shpjegimet e tyre, Autoriteti Kontraktor thote qe duhet te ishite ankimuar. Ne e kemi konsideruara percaktimet e bere ne DST per ketë ceshtje si totalisht ne kundërshtim me ligjin dhe kemi qene te bindur qe plotesojme kerkesat ligjore per kualifikim dhe per te realizuar kete kontrate. Por, le te supozojme, qe per shume arsye, nuk arrihem te ankimohe mi per keto kritere te percaktuar te kategorizimeve te mjeteve ne kundërshtim me ligjin. Cfare do te thote kjo? Qe Autoriteti Kontraktor te shkele ligjin ne vendosjen e ketyre kritereve dhe serisht te vazhdoje te shkele ligjin ne vleresimin e ofertave dhe kuotim sipas interesave te ngushta, sepse nje ofertues nuk arriti te ankohet brenda afatit per ca kerkesa kualifimi absurde dhe ne kundërshtim me ligjin. Jo, kjo nuk eshte fryma qe mbart Ligji i Prokurimit Publik dhe akteve të tjera nenligjore te dala ne zbatim te tij. Por, le te mbetemi serisht tek Ligji i Prokurimit Publik. Le te supozojme qe ne nuk plotesojme ato kritere ndonese te vendosur ne shkelje te ligjit dhe akteve nenligjore. Ne funksion te objektit dhe qellimeve qe ka Ligji i Prokurimit Publik, nder te cilat edhe te siguroje mireperdorimin e fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale, ligjvenes i, jo rastesisht, ka parashikuar ne piken 4, nenin 53 devijimet e vogla Citojme: “4. Autoriteti kontraktor vlereson nje oferte te vlefshme edhe nese ajo perman devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk ndryshojne thelbesisht karakteristikat, kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, te cilat mund te korrigjohen pa prekur permbajtjen e saj.” A e ka marre ne konsiderate KVO e autoriteit kontraktor kete pike, duke i konsideruar shmangien qe ne kemi ne karakteristika e automjeteve ne raport me klasifikimet dhe kerkesat e cuditshme dhe ka vendosur autoriteti kontraktor, si devijime te vogla. Jo, nuk e ka marre aspak ne konsiderate. Sepse, ka kerkuar "gjilperen" ne "kashte". Ka kerkuar te gjeje arsye pa arsye per te skualifikuar ofertën tone. Eshte mjaftuar me aq. Nuk ploteson kriteret tona (te percaktuara ne DST), dhe skualifikohesh pavaresisht se si jane percaktuar keto kritere.

Te nderuar anetarë te KPP, i shprehur qe ne nenin 1, te ligjit te prokurimit publik, qellimi i procedurave te prokurimit publik, eshte te rrishe eficencen dhe efikasitetin e perdorimit te parave publike: te nxise pjesmarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit dhe te nxise konkurrencen, te siguroje mireperdorimin e fondeve publike e te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatoret ekonomike pjesmarres ne procedura prokurimi. Duke

qene se kemi shume eksperience me prokurimet publike dhe duke respektuar ligjin, dhe duke besuar ne vleresimin dhe gjykimin tuaj te drejte, ne do te presim vendimin tuaj ne lidhje ankesen tone per vleresimin e bere nga Anetaret e KVO dhe Autoritetit kontraktor. Nderkohe qe qendrimi jone ne lidhje me anetaret e Komisionit te Vleresimit te Ofertave dhe Autoritetin Kontraktor, do te jete ne perputhje me ligjin, ne do te ndjekim te gjitha rruget ligjore administrative dhe penale qe persona te tille dhe vleresime te tilla te mos shkojne favorizojne interesa te ngushta te ketyre anetareve apo subjekteve te ndryshme ofertuese, por te shkojne vetem ne favor te perdorimit sa me te mire te fondeve publike. Ne do presim vendimin Tuaj dhe me pas do te ndjekim te gjitha rruget ligjore administrative dhe penale per te siguruar nje proces te drejte dhe transparent te pjesmarrjes ne kete procedure prokurimi dhe kriterete te vendosura per pjesmarrjen. [...].

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. K-578/1 prot., datë 19.02.2019, protokolluar me tonën në datën 21.02.2019, me objekt “Informacion i hollësishëm mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim rrjet kanalizimi në zonën që kufizohet nga rrugët "Besnik Hidri", "Bashkim Shkurti", "Coca Cola" deri në lumin “Lana””, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Curri” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamionçina vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secilin kamionçinë për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nuk ka paraqitur asnjë kamionçinë me tonazhin e kërkuar nga AK. Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionçinë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 1.5 ton dhe maksimumi 2 ton për secilin kamionçinë të kërkuar nga AK (4 cope), për rrjedhojë i pavlefshëm.” nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë:

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik:_____

Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt:_____

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

III.1.2. Gjithashtu, në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 13 e “Kapacitetit teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

“13. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	4 cope	Pronësi ose me qera

Pompe uji	1 cope	Pronësi ose me qera
Vinç	1 cope	Pronësi ose me qera
Tokmak	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Prerese asfalti	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul	2 cope	Pronësi ose me qera
Sonde shpimi	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 90 copë
 - Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
 - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
 - Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohej dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).*
- g) *(opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në datë 08.01.2019 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa*

paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorisë së Prokurimit UKT sha.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Curri” sh.p.k., për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

- Deklaratë ”Mbi disponimin e makinerive” e operatorit ekonomik ”Curri” sh.p.k., ku ky i fundit deklaron se ka në pronësi 4 (katër) kamioncina.
- Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë AA653HA
 - Leje qarkullimi
 - Certifikatë e kontrollit teknik
 - Siguracionin e mjetit
 - Foto e mjetit
 - Licencë nr.09 datë 26.01.2017 ”Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit”, lëshuar nga Bashkia Malësi e Madhe
- Leje qarkullimi mjeti me targë AA395OS
 - Certifikatë e kontrollit teknik
 - Siguracionin e mjetit
 - Foto e mjetit
- Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë AA179OL
 - Leje qarkullimi
 - Certifikatë e kontrollit teknik
 - Siguracionin e mjetit
 - Foto e mjetit
 - Licencë nr.99 datë 27.09.2016 ”Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit”, lëshuar nga Bashkia Malësi e Madhe
 - Licencë nr.09 datë 26.01.2017 ”Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit”, lëshuar nga Bashkia Malësi e Madhe
- Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë AA244UC
 - Leje qarkullimi
 - Certifikatë e kontrollit teknik
 - Siguracionin e mjetit
 - Foto e mjetit

III.1.4. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.1.5. Në nenin 26, pika 8/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*”

III.1.6. Ndërsa në nenin 26 pika 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*”.

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm me anë të të cilit të vërtetojnë se disponojnë 4 (katër) kamionciona me kapacitet mbajtës minimumi 1.5 ton dhe maksimumi 2 ton.

Në verifikim të përmbushjes së kriterit për mjetet kamioncinë, që është edhe arsyeja e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor për operatorin ekonomik “Curri” sh.p.k., rezulton se, ky i fundit për këtë kriter ka paraqitur deklaratën mbi disponimin e mjeteve, ku deklaron se ka në pronësi 4 (katër) kamioncina, konkretisht mjetet me targë AA653HA; AA395OS; AA179OL dhe AA244UC, si dhe dokumentacionin përkatës për këto mjete (certifikata e pronësisë, leje qarkullimi të mjeteve përkatëse, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni etj). Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit për mjetet kamioncina, konkretisht, për mjetet me targa AA653HA; AA395OS; AA179OL dhe AA244UC, referuar lejes së qarkullimit të secilit mjet, rezulton se, secili prej tyre ka një kapacitet mbajtës me të ulët se 1.5 ton, si kapacitet mbajtës minimal që autoriteti kontraktor ka kërkuar në dokumentat e tenderit për secilën kamioncinë. Pra, asnjë nga mjetet Kamioncinë të paraqitura nga operatorit ekonomik ankimues, nuk plotëson kapacitetin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Si rrjedhim, në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar shprehimisht kriteri që, duhet të paraqitet dokumentacioni i nevojshëm për 4 mjete kamioncina me kapacitet mbajtës nga minimumi 1.5 ton deri në maksimumi 2 ton, konstatohet se operatori ekonomik ankimues nuk ka arritur të vërtetojë se disponon mjete të tilla duke mos e plotësuar kështu kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për mjetet kamioncinë.

Akoma më tej, vetë operatori ekonomik ankimues, si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, ashtu dhe në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik ka pranuar

shprehimisht se ka paraqitur 4 kamioncina me kapacitet më të ulët se 1.5 ton, konkretisht “Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. ka paraqitur ne kete procedurë prokurimi automjetet si më poshtë: Kamioncina: - Kamioncine me targa AA653HA me kapacitet mbajtesi 1.2 ton; - Kamioncine me targa AA395OS me kapacitet mbajtesi 0.9 Ton; -Kamioncine me targa AA179OL me kapacitet mbajtesi 1.3 Ton; -Kamioncine me targa AA244UC me kapacitet mbajtesi 1.03 Ton.”. Pra, operatori ekonomik ankimues pranon fakti që këto mjete nuk plotësojnë kërkesat e autoriteti kontraktor në lidhje me kapacitetin mbajtës, për mjetat kamioncina.

III.1.9. Për më tepër, përsa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Curri” sh.p.k. se “Ne kemi përmbushur kërkesën e autoritetit kontraktor për të disponuar 4 automjete kamioncina. Ndarja qe ju i keni bere tonazhit nga 1.5 - 2 ton, eshte ne kundërshtim me ligjin Nr.8378, date 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet e tjera ligjore.”, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Curri” sh.p.k. mbi arsyet e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas

arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k. për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me nr. REF-99519-12-17-2018, me objekt, *“Ndërtim rrjet kanalizimi në zonën që kufizohet nga rrugët “Besnik Hidri”, “Bashkim Shkurti”, “Coca Cola” deri në lumin “Lana”*, me fond limit 75.745.805 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 18.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 228 Protokolli

Datë 13.02.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	Vilma Zhupaj	Lindita Skeja

Kryetar
Evis Shurdha